

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 01.04.2025

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 42.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : me numër identifikimi : 632-24-9630-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-106-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-16775, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, me dt.01.04.2025, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM
Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në shkollën “Mazllom Këpuska” punimet nuk kanë mundur të realizohen për arsye se gypat për të cilën kanë qenë në Pëlqim Elektroenergjetik të KEDS-it, nuk ka mundur të realizohen sepse Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk ka lejuar demolimin e kubëzave. Arsyeja tjetër ka qenë se pas kërkesës për revidim të Pëlqimit Elektroenergjetik në KEDS, i njëjti nuk ka dhënë pëlqim për revidim, prandaj projekti nuk mund të realizohet. Për këtë arsye kontrata me numër të prokurimit : me numër identifikimi : 632-24-9630-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-24-106-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-16775, e nënshkruar me datën 01.11.2024, me titull “ Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve “VOLTECHZ” sh.p.k., Magj.Prishtinë Ferizaj – Gracanice, Prishtinë, me numër unik 810066680,, NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.

2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës dhe Kryesi i punëve, në pajtim me nenin 42, paragrafi 42.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), si dhe kërkesën e dt.21.03.2025, të menaxherit të kontratës, kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për “Rregullimi i instalimit elektrik në shkollat “Yll Morina”, “Selman Riza” dhe “Mazllom Këpuska”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve “VOLTECHZ” sh.p.k., Magj.Prishtinë Ferizaj – Gracanice, Prishtinë, me numër unik 810066680, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxherët e Kontratës të Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre, përmes kërkesës së dërguar në Zyrën e Prokurimit me date 26.03.2025, kanë kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës.

Me date 28.03.2025, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për ndërprerje me marrëveshje të kontratës” te kryesi i punëve “VOLTECHZ” sh.p.k., Magj.Prishtinë Ferizaj – Gracanice, Prishtinë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.


Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj

për: 
Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Arsim;
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
Menaxherit të kontratës;
Organit Mbikëqyrës;
Arkivës së Komunës.